



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës

## KONTRATË PËR SHERBIME

**KOMUNA E ISTOGUT, ZYRA E PROKURIMIT, të cilën e perfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Zizë Bujupaj, Rruga “Fadil Ferati” në njërën anë; dhe**

**“Valmir Loshi B.I. ” me NRB 811226564, nga Gurrakoci, Komuna e Istogut, të cilën e perfaqëson z. Valmir Loshi në cilësinë e drejtorit të ndermarrjes nga ana tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:**

### **TITULLI I KONTRATËS**

#### **MIRËMBAJTJA E STADIONIT TË QYTETIT TË ISTOGUT**

<b>Nr. I prokurimit</b>	<b>633 – 020 -1238 -2-3-6 C 326</b>
<b>I brendshëm</b>	<b>633-020 / 013-236 C326</b>

### **Neni 1 Lënda**

#### **1.1 MIRËMBAJTJA E STADIONIT TË QYTETIT TË ISTOGUT**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **09.06.2020** dhe përfundon me **31.12.2020**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **30. ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë **STADIONI I QYTETIT TË ISTOGUT”**

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozitë të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3.333,30 €**;  
**Me shkronja "Tremijë/Treçind/Tridhjetë/Tre euroe 30/100"**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2. Autoriteti Kontraktues do ta paguaj shumën totale të pagesës pas kryerjes së shërbimeve

4.3. Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të Shërbimeve

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i kryejë njërin ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve, deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9            Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10           Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11           Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënues nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12           Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13           Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrim.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin i identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


E hartuar në gjuhën Shqipe dhe Serbisht në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

**Për Autoritetin Kontraktues  
Komuna e Istoguti**

**Për Kontraktorin:  
"Valmir Loshi B.I"**

<b>Emri:</b>	<i>Zizë Bujupaj</i>	<b>Emri:</b>	<i>Valmir Loshi</i>
<b>Pozita:</b>	<i>Zyrtar Përgjegjës I Prokurimit</i>	<b>Pozita:</b>	<i>D r e j t o r</i>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<i>15/06/2020</i>	<b>Data:</b>	<i>15/06/2020</i>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

KOMUNA E ISTOGUT					
Mirembajtja e stadiumit te futbollit					
KOMUNA E ISTOGUT					
Specifikimi i punëve	Njësia	Sasia	Cmimi/ Njesi	TOTALI	
1	Furnizimi dhe vendosja e rollneve me bari natyral	m2	100	1.0 €	100.0 €
2	Furnizimi dhe Shpërndarja e plehit azotik ne sezonin KAN	kg	200	0.5 €	100.0 €
3	Furnizimi dhe shpërndarja e plehit artificial UREA	kg	200	0.5 €	100.0 €
4	Shporta per hudhjen e mbeturinave me dimensione 1m dhe me diameter 80 .	Cope	10	65.0 €	650.0 €
5	Fare -Prato Goal për fusha futbollit ,furnizimi dhe shperndarja e fares	kg	50	4.0 €	200.0 €
6	Furnizimi me Humus - Kompost i dheut për bare si dhe te behet shpërndarja e tij	kg	500	0.5 €	250.0 €
7	Nivelizimi i terenit ngjeshja e tij me cilindër me peshe 1000-1200 kg në dimensionet e fushës 100x70 m. Fusha duhet te cilndrohet 10 here .	Cope	10	50.0 €	500.0 €
8	Germimi i dheut te kat. III-IV-tëper hapjen e themeleve me dimensionet 20x30cm dhe perimeter te objektit 10m	m3	1	150.00	150.0 €
9	Furnizimi dhe betoni i dhemeleve nentoksore me dim.20x30cm dhe pllakes me siperfaqe 3x2mx10cm.Betonimi te behet me beton te armuar me markë te betonit MB25	m3	2	60.00	120.0 €
10	Furnizimi dhe muratimi i mureve te mbrendshme dhe te jashtme te Toaleteve me giter blloka,Ne llogari te parashihen edhe perkrahjet e nevojshme,llogaria për m2 te objektit e duke llogaritur ne lartesi te objektit h=2.5mSiperfaqja e objektit te ndahet ne dy pjesë me dy hyrje,ndaras femra dhe meshkuj	m2	6	20.00	120.0 €
11	Furnizimi me material per punimin e pllakës se katit duke llogaritur ne Fert pllakë dhe vendosje te betonit per tërë siperfaqën se pllakës me nje pjerrtësi( ramje 5%).Ne llogari te parashihen edhe perkrahjet e nevojshme për kryerjen e një aktiviteti te tillë.Trashësi e pllakës te jetë d=12cm.Llogaria per meter kub	m3	2	70.0 €	140.0 €
12	Blerja furnizimi dhe vendosja e WC Galuceve me te gjitha paisjet e nevojshme ndihmese per nje aktivitet te tillë	copë	2	80.0 €	160.0 €
13	Blerja furnizimi dhe vendosja e lavamaneve me te gjitha paisjet e nevojshme ndihmese per nje aktivitet te tillë duke perfshirë kronin; për ujë,dhe nje pasqyrë me dimensione 60x40cm	copë	2	80.0 €	160.0 €
14	Furnizimi dhe vendosja e dyerve per hyrje ne toalet dyert te jenë nga mas plastike dhe me dimensione 200x90cm	copë	2	180.0 €	360.0 €
15	Furnizimi dhe vendosja e dritareve te plastikës dhe me dimensione 40x40cm	copë	2	45.0 €	90.0 €
16	Furnizimi me material(gyp) dhe pjesë fazonike te ujsjellist per furnizimin e objektit me ujë e po ashtu ne llogari te parashihet edhe hapja e kanalit dhe vendosja e gypit e po ashtu edhe kyqja ne gypin furnizues ne rrugen për Istog te poshtem	m*	20	4.0 €	80.0 €
17	Furnizimi me material-gyp te kanalizimit dhe pasijet tjera mbeshtetese per largimin e fekaleve nga objekti e deri ne drenazhen e fushes dhe atë me nje largësi deri ne 10m deri ne derdhje	m,	10	5.3 €	53.3 €
<b>TOTALI ME TE GIJTHA NGARKESAT</b>					<b>3,333.3 €</b>

Identifikimi i Operatorit Ekonomik	
Emri i Kompanise	NNT „LOSHI-DESIGN„
Adresa e Plote	GURRAKOC-ISTOG
Perfaqesuar Nga:	
Emri	VALMIR LOSHI
Pozita	DREJTOR
Nenshkrimi	
Data	16/04/2020
Vula	